



INSTITUTI I KOSOVËS PËR DREJTËSI
KOSOVO LAW INSTITUTE
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

PROKURORËT NË KOSOVË NGRISIN AKTAKUZA NDAJ TË VDEKURVE



Prishtinë, nëntor 2019

Autor: Arrita Reznici

Redaktorët: Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Nëntor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Shkeljet me rastin ngritjes së aktakuzave ndaj personave të vdekur	5
3. Rastet e veçanta të shkeljes së ligjit në ngritjen e aktakuzave ndaj personave të vdekur	7
3.1. Rasti 1 – Aktakuza e ngritur 15 vjet pas vdekjes së të pandehurit dhe arrestimi i personit të gabuar.....	8
3.2. Rasti 2 – Aktakuza e ngritur 13 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	9
3.3. Rasti 3 – Aktakuza e ngritur 13 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	10
3.4. Rasti 4 – Aktakuza e ngritur 10 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	11
3.5. Rasti 5 – Aktakuza e ngritur 9 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	12
3.6. Rasti 6 – Aktakuza e ngritur 9 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	13
3.7. Rasti 7 – Aktakuza e ngritur 8 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	14
3.8. Rasti 8 – Aktakuza e ngritur 7 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	15
3.9. Rasti 9 – Aktakuza e ngritur 6 vjet pas vdekjes së të pandehurit.....	16
4. Pasojat e shkaktuara nga ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta	17
5. Rekomandimet	18

1. Përmbledhje ekzekutive

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në mënyrë sistematike monitoron seancat gjyqësore që zhvillohen në të gjitha departamentet e të gjitha Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës dhe degëve të tyre. Si rrjedhojë e këtij procesi, në baza ditore publikohen raportet e monitorimit të këtyre seancave¹, të cilat pastaj analizohen një nga një.

Përgjatë analizës së realizuar, IKD ka gjetur se vetëm gjatë dy viteve të fundit ka pasur një numër të konsiderueshëm të rasteve, për të cilat në shqyrtim fillestar, gjyqtarët kanë nxjerrë aktvendim për pushim të procedurës, për shkak se të akuzuarit kishin ndërruar jetë para ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë.

Pra, në gjykatë, prokurorët kishin dorëzuar aktakuza të ngritura kundër personave të vdekur.

Kjo dëshmon se procedura e hetimeve nga prokurorët në vendin tonë nuk kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara. Madje aktakuzat ngritën pa kryer hetime fare dhe as pa i dhënë mundësinë të dyshuarve që të deklarohen apo merren në pyetje lidhur me dyshimet e pretenduara në aktakuzë.

Praktika ka treguar se në rastet e ngritjes së këtyre aktakuzave (të drejtpërdrejta) evidentohen shkelje ndaj të drejtave të të pandehurve dhe njëkohësisht edhe pasoja të tjera, ku në një rast të trajtuar në këtë raport, urdhër arresti i lëshuar nga gjykata, si rrjedhojë e aktakuzës së ngritur pas vdekjes së të akuzuarit, është zbatuar gabimisht, duke çuar kështu në arrestimin e një personi krejtësisht tjetër me emër dhe mbiemër të njëjtë me personin që kishte ndërruar jetë.

Ndërsa, në rastet e tjera, kryesisht të ngjashme njëri me tjetrin, janë evidentuar pasojat që shkaktohen me ngritjen e aktakuzave në këtë mënyrë, duke filluar kështu nga shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut, krijimi i pasigurisë juridike, dëmtimi i imazhit dhe kredibilitetit të sistemit të drejtësisë, si dhe ulja e besimit të publikut lidhur me integritetin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Në këtë raport, IKD ka trajtuar veç e veç, disa nga rastet e evidentuara nga procesi i monitorimit, ka analizuar këto raste bashkërisht dhe pastaj ka paraqitur gjetjet si një tërësi mbi trajtimin e kësaj problematike, ka evidentuar pasojat që shkaktohen si rrjedhojë e ngritjes së aktakuzave në këtë mënyrë, ka paraqitur karakteristikat e veçanta të secilit rast veç e veç, si dhe në fund ka nxjerrë rekomandime konkrete për evitimin e kësaj situatë në të ardhmen.

¹ Linku ku mund të lexoni të gjitha raportet e publikuara nga seancat e monitoruara: www.betimiperdrejtesi.com

2. Shkeljet me rastin ngritjes së aktakuzave ndaj personave të vdekur

Praktika ka dëshmuar se prokurorët po akuzojnë numër të konsiderueshëm të personave pa kryer fare hetime. Një rrethanë e tillë është e papranueshme, meqë qëllimi i hetimit është mbledhja e provave dhe të dhënave të nevojshme për të vendosur nëse duhet të ngritet aktakuza apo duhet të pushohet procedura.²

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) ka paraparë se kur policia apo ndonjë person tjetër bën kallëzim penal tek prokurori i shtetit për një dyshim të arsyeshëm për një ose disa vepra penale, asnjëra nga të cilat nuk dënohet me më shumë se tre vjet burgim dhe prokurori vlerëson se ekziston dyshim i bazuar mirë për të mbështetur aktakuzën, ai mund të ngritë aktakuzë.³

Megjithatë, kjo është përjashtim, nuk është rregull, , për arsye se edhe për veprat penale për të cilat ligji parasheh dënim me burg deri në 3 vjet, parimisht do të duhej të udhëhiqeshin hetime, të zbatoheshin hetimet dhe akuza të jetë produkt i këtyre hetimeve që janë zhvilluar.⁴

Aq më tepër kur ky përjashtim, iu lejohej prokurorëve vetëm në rastet kur dyshimi është i bazuar mirë. E KPPRK ka paraparë se dyshimi i bazuar mirë nënkupton posedimin e provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri.⁵

Andaj, nuk mund të lejohet ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta vetëm për shkak se i pandehuri akuzohet për një vepër penale të dënueshme deri në tre vjet burgim, por domosdo duhet të plotësohet edhe kriteri tjetër, pra dyshimi të jetë i bazuar mirë. Dënueshmëria deri në tre vjet përbën thjesht një kusht formal, mirëpo prokurori duhet pasur kujdes dhe të shohë se a është plotësuar edhe kushti tjetër, ai i dyshimit të bazuar mirë, në mënyrë që kur të ngritet aktakuza, mos të mundësojë dilema rreth asaj çfarë ka ndodhur, dhe se kryesi i kësaj vepre penale është i pandehuri.

Sa i përket dyshimit të bazuar mirë, nuk mund të themi se ekziston kur kemi një kallëzim penal me të meta. Për të qenë një kallëzim penal i bazuar mirë, duhet identifikuar mirë dhe drejt kryerësi i veprës penale, pastaj duhet siguruar se a ka prova të sigurt që e argumentojnë atë që po thuhet në kallëzim penal lidhur me veprimin ose mosveprimin. Duhet të jetë i mbështetur në fakte të pakontestueshme që të shihet qartë se nuk është e nevojshme të zbatohen hetimet dhe vetëm në këto rrethana, prokurori mund të ngritë aktakuzë të drejtpërdrejtë.⁶

Në këtë drejtim, të gjithë akterët të cilët marrin pjesë në procedurë penale duhet të kenë kujdes në kryerjen e obligimeve të tyre, të cilat janë paraparë shumë qartë me KPPRK. Ky Kod ka përcaktuar se gjykata, prokurori i shtetit dhe policia, të cilët marrin pjesë në

² Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 103, par. 1.

³ Po aty, Neni 101, par. 2.

⁴ Intervistë me ish Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, prof. Fejzullah Hasani, Prishtinë, 3 tetor 2018.

⁵ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 19, par. 1, nënpar. 13.

⁶ Intervistë me ish Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, prof. Fejzullah Hasani, Prishtinë, 3 tetor 2018.

procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet, të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm.⁷

KPPRK rrjedhimisht ka ndërtuar standardin përmes të cilit obligon prokurorin e shtetit dhe policinë që marrin pjesë në procedurë penale që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe ato në favor të tij, si dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.⁸

Rastet e të akuzuarve (kryesisht për veprën penale "vjedhja e shërbimeve komunale") të trajtuara më detajisht në vijim të raportit, dëshmojnë se ata janë përballur me aktakuzë thjesht për shkak se njehsori elektrik ka qenë i regjistruar në emër të tyre.

Në bazë të KPPRK i pandehuri dhe prokurori i shtetit, në procedurë penale, kanë pozitë të barabartë. I pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë që të kërkojë nga prokurori i shtetit të thërret dëshmitarë në emër të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij.⁹

Në rastet e trajtuara në këtë raport, të pandehurve asnjëherë nuk i është dhënë një mundësi e tillë, gjë që ka pamundësuar edhe vërtetimin e përgjegjësisë, duke ditur se tek personat fizik vlen parimi i përgjegjësisë subjektive dhe nëse një person është fajtor, atëherë duhet provuar fajësia e të njëjtit. Nëse flasim konkretisht për rastet e trajtuara në këtë raport, atëherë themi se duhet provuar që personi përkatës është ai i cili ka ndërhyrë në njehsorin elektrik respektiv dhe të mos mjaftohemi me faktin e vetëm se njehsori ka qenë në emër të tij.

Është thjesht obligim i çdo prokurori që hetimin ta kryejë me kujdes të veçantë dhe respektim maksimal të të drejtave të të pandehurit, që do të thotë se ndjekja e tyre, e aq më tepër ngritja e aktakuzave duhet bërë vetëm pasi që të ketë prova të cilat e arsyetojnë dyshimin e bazuar, apo pasi i pandehuri të ketë mundësi të deklarohet, qoftë direkt – me gojë, apo me shkrim.

Në të kundërtën, mund të themi se kemi shkelje edhe të ligjit për Prokurorin e Shtetit, me të cilin parashihen detyrat e Prokurorit, ku shprehimisht ceken zbatimi i standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, e po ashtu edhe mbrojtja e të drejtave ligjore të personave të përfshirë – ndër të cilët edhe të të dyshimtëve apo të akuzuarve.¹⁰

Rastet e trajtuara në pjesën e fundit të këtij raporti dëshmojnë që prokurorët nuk kanë ndërmarrë fare veprime hetimore dhe as nuk kanë kontaktuar të dyshuarit, e si rrjedhojë kemi aktakuza tërësisht të paqëndrueshme, të tilla që nuk japin mundësi as të fillimit të shqyrtimit gjyqësor, meqë të akuzuarit janë persona veçse të vdekur.

⁷ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 7, par. 1.

⁸ Po aty, Neni 7, par. 2.

⁹ Po aty, Neni 9, par. 2.

¹⁰ Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, Neni 7, par. 1.2 dhe 1.5.

Në anën tjetër, KPPRK shprehimisht ka paraparë detyrimet e prokurorit të shtetit në rast të vdekjes së të pandehurit, ku thuhet se kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, prokurori i shtetit merr aktvendim për pushimin e procedurës penale¹¹. Që do të thotë se në rast të një hetimi të mirëfilltë, në asnjë nga rastet e trajtuara në vijim nga IKD, nuk do të vinte deri te ngritja e aktakuzës.

3. Rastet e veçanta të shkeljes së ligjit në ngritjen e aktakuzave ndaj personave të vdekur

Nga analizimi i rasteve individuale, rezulton që ngritja e aktakuzave direkte lidhet kryesisht me veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”. Të gjitha këtyre aktakuzave i ka paraprirë kallëzimi penal i ushtruar ana e KEDS – it, ndërsa këtij i ka paraprirë procesverbali i përpiluar nga ana e punëtorëve të së njëjtës kompani.

Në këtë drejtim shqetësues është po ashtu fakti se të paktën në një rast, në procesverbal, përkundër që i akuzuari veçse ka qenë i vdekur në kohën e përpilimit të tij, aty është shënuar “pala prezent”. Kjo do të thotë se procesverbali përmban të dhëna të pavërteta, të cilat kanë shërbyer si bazë për prokurorinë që të ngritë një aktakuzë, e cila më vonë ka rezultuar krejtësisht e paqëndrueshme.

Në rastin e parë të trajtuar në kapitullin në vijim, përveç ngritjes së aktakuzës ndaj personit veçse të ndjerë, situata është ndërlikuar edhe më tej, sepse në këtë rast gjykata ka lëshuar urdhër arrest ndaj tij dhe pastaj ky urdhër është zbatuar ndaj një personi krejtësisht tjetër, i cili e ka pasur emrin dhe mbiemrin e njëjtë me të akuzuarin e ndjerë, por të dhënat tjera personale krejtësisht ndryshe nga ai. E një rast si ky, më së miri ilustron pasojat që shkaktohen si rrjedhojë e kryerjes së detyrave me kujdes të nivelit jo të duhur nga institucionet gjegjëse.

Kurse, në rastet e tjera, kryesisht të ngjashme njëri me tjetrin, tregohet rrjedha e procedurës të secilit rast veç e veç, ku aktakuzat janë ngritur ndaj personave veçse të ndjerë.

Në pjesën në vijim të këtij raporti janë paraqitur vetëm nëntë nga rastet e fundit ku prokuroritë kanë ngritur aktakuza të tilla, raste këto të identifikuara nga IKD si rrjedhojë e procesit të monitorimit. Secili nga këto raste, në mënyrë të individualizuar, saktësisht tregon rrjedhën e procedurës, duke filluar nga ngritja e aktakuzës prej prokurorisë, zhvillimi i mëtutjeshëm i rastit dhe në fund edhe pushimi i procedurës nga ana e gjykatës.

¹¹ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 160.

3.1. Rasti 1 – Aktakuza e ngritur 15 vjet pas vdekjes së të pandehurit dhe arrestimi i personit të gabuar¹²

Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: P.nr.783/17

Vepra penale: Lidhja e paautorizuar në shërbime

Data e ngritjes së aktakuzës: 28 korrik 2017

Data e vdekjes së të pandehurit: në vitin 2002¹³

Prokuroria Themelore në Pejë kishte ngritur aktakuzë ndaj T.S. më 28 korrik të vitit 2017, me të cilën të akuzuarin e ngarkonte për veprën penale “lidhja e paautorizuar në shërbime”.

Për këtë rast, disa herë kishin dështuar të mbaheshin seancat, andaj për ta siguruar praninë e të akuzuarit në seancë gjyqësore, Gjykata Themelore në Pejë, më 17 gusht 2019, kishte lëshuar urdhërarrest ndaj T.S.

Pas kësaj, një person tjetër me emrin T.S, i njëjtë sikurse ai në aktakuzë, ishte arrestuar pasi kishte ardhur nga Zvicra në Kosovë. Ai është paraqitur në seancën 19 gushtit 2019, duke deklaruar se nuk është personi të cilin e akuzon Prokuroria e Pejës. Po ashtu, kishte thënë se nuk jeton në Pejë, por në një fshat të Komunës së Gjakovës, e që më pas është vërtetuar se emrin dhe mbiemrin e ka të njëjtë me të akuzuarin, por që bëhet fjalë për një person tjetër.

Në seancën e mbajtur më 19 gusht 2019, ka marrë pjesë edhe djali i të akuzuarit T.S, i cili ka thënë se babai i tij, ka vdekur para 17 vjetëve në Zvicër.

Pas këtyre informatave, gjykatësja Florije Zatriqi, e ka hudhur poshtë aktakuzën në këtë rast, pasi nga e njëjta, paraprakisht është tërhequr prokurorja Ardiana Veseli, e cila ka deklaruar që aktakuza është ngritur në bazë të kallëzimit penal të paraqitur nga ana e KEDS – it.

Sipas aktakuzës, T.S. akuzohej se më 5 maj të vitit 2015, në shtëpinë e tij, në Pejë, pa autorizim të furnizuesit, është lidhur direkt në rrjetin elektrik, në atë mënyrë që i njëjti, nga ana e komisionit të KEDS-it është hasur se furnizohet me energji elektrike, në mënyrë të kundërligjshme. Me këtë, pretendohet se i ka shkaktuar dëm KEDS-it në shumë prej 564.44 euro.

¹² “*“Huqja” e radhës, hudhet poshtë aktakuza pasi vërtetohet se ishte ngritur ndaj personit që ka vdekur para 17 vjetësh, u arrestua personi me emrin e njëjtë*”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/huqja-e-radhes-hudhet-poshte-aktakuza-pasi-vertetohet-se-ishte-ngritur-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-para-17-vjetesh-u-arrestua-personi-me-emrin-e-njejte/>).

¹³ *Sqarim:* Nuk dihet data e saktë e vdekjes, meqë në shkresa të lëndës nuk ka certifikatë të vdekjes. Mirëpo, në bazë të deklaratave të dhëna në seancën e mbajtur më 19 gusht 2019, rezulton se i akuzuari ka vdekur para 17 vjetësh. Ndërsa, djali i tij ka deklaruar që certifikatën e vdekjes së të atit, do t’ia dërgojë të skanuar Prokurorisë Themelore në Pejë, pasi të kthehet në Zvicër, ku edhe ka vdekur babai i tij.

3.2. Rasti 2 – Aktakuza e ngritur 13 vjet pas vdekjes së të pandehurit¹⁴

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega Podujevë

Nr. i lëndës: P.nr.681/2018

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 1 nëntor 2018

Data e vdekjes së të pandehurit: në vitin 2005¹⁵

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 1 nëntor të vitit 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj F.B, për shkak të veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale”. Kjo prokurori, e akuzonte atë se në mars të vitit 2018, ishte kyçur ilegalisht në rrjetin elektrik, me çka pretendohet se i kishte shkaktuar dëm KEDS-it, në shumë prej 57.24 euro.

Lidhur me këtë akuzë, Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, më 31 maj të vitit 2019, e kishte caktuar seancën fillestare, mirëpo aty kishte munguar i akuzuari. Për shkak të mungesës së tij, kjo gjykatë kishte lëshuar urdhëresë për sjellje me detyrim ndaj të akuzuarit F.B., por Stacioni Policor në Podujevë e kishte informuar gjykatën se nga kërkimet për të akuzuarin, ka rezultuar se ai ka vdekur para 14 vjetësh.

Pas marrjes së kësaj informate, gjykatësja Elheme Jashari, ka marrë aktvendim përmes së cilit e ka pushuar këtë procedurë penale. Në aktvendim thuhet se kompania KEDS, si palë e dëmtuar, për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest civil, ndërsa shpenzimet e kësaj procedure gjyqësore bien në barrën e gjykatës.

Sipas aktakuzës, F.B akuzohet se në fshatin Bellopojë të Podujevës, më 8 mars 2018, pas kontrollit nga ana e punëtorëve të KEDS-it, është gjetur se ai pasi ishte shkyçur nga njehsori elektrik, ishte lidhur në rrjet elektrik jashtë njehsorit, në mënyrë të kundërligjshme. Siç thuhet në aktakuzë, KEDS-i kishte pësuar dëm material në lartësi prej 57.24 euro.

Para ngritjes së kësaj aktakuze, prokuroria më 12 qershor 2018, kishte pranuar kallëzim penal nga ana e KEDS – it lidhur me këtë rast.

¹⁴ “Prokuroria vitin e kaluar kishte ngritur aktakuzë ndaj personit që kishte vdekur para 14 vjetësh, ndaj tij ishte lëshuar edhe urdhërarrest”. Betimi për Drejtësi. 8 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-vitin-e-kaluar-kishte-ngritur-aktakuze-ndaj-personit-qe-kishte-vdekur-para-14-vjetesh-ndaj-tij-ishte-leshuar-edhe-urdherarrest/>).

¹⁵ Sqarim: Nuk dihet data e saktë e vdekjes, meqë në shkresa të lëndës nuk ka certifikatë të vdekjes. Megjithatë, nga Gjykata jemi informuar se të dhënat janë marrë nga Policia e Kosovës, ku thuhet se i akuzuari ka vdekur para 14 vjetësh dhe në bazë të këtyre informatave edhe është marrë aktvendimi për pushim të procedurës.

3.3. Rasti 3 – Aktakuza e ngritur 13 vjet pas vdekjes së të pandehurit¹⁶

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Nr. i lëndës: P.nr.331/18

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 25 prill 2018

Data e vdekjes së të pandehurit: 17 maj 2005

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, më 25 prill 2018, ka ngritur aktakuzë kundër B.F, për shkak të veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale”. Aktakuza e ngarkon atë se veprën penale e ka kryer në qershor të vitit 2017.

Por, nga dokumentet zyrtare, del se personi ndaj të cilit është ngritur aktakuzë, ka vdekur në vitin 2005. Policia e Kosovës, përmes një shkrese e ka njoftuar Gjykatën Themelore në Mitrovicë, se i akuzuari në fjalë ka ndërruar jetë më 17 maj të vitit 2005, me ç’rast njoftimit i kishin bashkëngjitur edhe certifikatën e vdekjes.

Pas marrjes së këtyre informatave, gjykatësi i rastit, Bekim Veliki e ka pushuar procedurën penale në këtë rast.

E veçantë tjetër këtu është edhe fakti se tek të dhënat personale të të akuzuarit të cekura në aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, përmendet vetëm se i akuzuar është B.F nga fshati Broboniq, Komuna e Mitrovicës, numri personal i tij dhe shtetësia, ndërkaq nuk janë fare të cekura të dhënat e tjera personale si data dhe vendi i lindjes, profesioni, shkollimi i përfunduar, gjendja e tij ekonomike dhe detaje të tjera të cilat zakonisht ceken në aktakuzat e Prokurorisë.

Kësaj aktakuze, i kishte paraprirë kallëzimi penal i KEDS-it, në procesverbalin e kontrollit për konstatimin e vjedhjes së rrymës, të së cilës, më 15 korrik 2017, si konsumator kishin shënuar emrin e B.F dhe në fund të këtij procesverbali kishin shënuar “pala prezent, refuzon”.

Kallëzimi penal i 12 dhjetorit 2017, kundër të pandehurit B.F, është ngritur nën dyshimin për kryerjen e veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale”.

¹⁶ “Ekskluzive: Prokuroria në Mitrovicë ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur para 13 vjetësh”. Betimi për Drejtësi. 25 tetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-prokuroria-ne-mitrovice-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-para-13-vjetesh/>).

3.4. Rasti 4 – Aktakuza e ngritur 10 vjet pas vdekjes së të pandehurit¹⁷

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.5436/16

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 22 dhjetor 2016

Data e vdekjes së të pandehurit: 18 janar 2007

Prokuroria Themelore në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2016, ka ngritur aktakuzë ndaj A.G për veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”, pasi që sipas aktit akuzues, ai ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, duke bërë lidhje direkte jashtë pikës matëse, me ç’rast i ka shkaktuar dëm KEDS-it në vlerën mbi 452 euro.

Por, Policia e Kosovës përmes një parashprese kishte njoftuar gjykatën se i akuzuari ka vdekur. Të njëjtin konfirmim gjykatës ia kishte dërguar edhe Shërbimi i Gjendjes Civile, të cilët, shkresës së dërguar në gjykatë ia kishin bashkëngjitur edhe certifikatën e vdekjes së të akuzuarit A.G., ku evidentohet se ai kishte ndërruar jetë më 18 janar 2007.

Në këto rrethana, gjykatësi i çështjes, Kushtrim Shyti kishte pushuar procedurën penale kundër të akuzuarit A.G.

Ndryshe, Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 22 dhjetor 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj A.G. për shkak të veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale”, nga neni 320 të KPRK-së.

Sipas prokurorisë, më 16 dhjetor 2015, në shtëpinë e tij në fshatin “Hajvali”, Komuna e Prishtinës, i akuzuari ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar.

Prokuroria pretendonte se i njëjti ka bërë anashkalimin e njësisë matëse-njehsorit elektrik, duke bërë lidhje direkte jashtë pikës matëse pa autorizimin e furnizuesit përkatës, KEDS-it, me qëllim që rryma e shpenzuar të mos regjistrohet dhe faturohet fare, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 452,36 euro.

Para ngritjes së kësaj aktakuze, KEDS – i, kishte paraqitur kallëzim penal ndaj A.G. më 29 qershor 2016.

¹⁷ “Prokuroria ngrit aktakuzë ndaj personit që ka vdekur në vitin 2007, gjykata pushon procedurën penale”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrit-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-ne-vitin-2007-gjykata-pushon-proceduren-penale/>).

3.5. Rasti 5 – Aktakuza e ngritur 9 vjet pas vdekjes së të pandehurit¹⁸

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.5458/16

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 23 dhjetor 2016

Data e vdekjes së të pandehurit: 27 maj 2007

Prokuroria Themelore në Prishtinë më 23 dhjetor 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj I.I, me pretendimin se ai kishte kryer veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”. Kjo prokurori e akuzonte atë se më 29 janar 2016, në shtëpinë e tij në Prishtinë, ishte hasur duke shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të kundërligjshme.

Lidhur me këtë aktakuzë, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 25 korrik 2019, mirëpo nga fletëkthesa rezultonte se i akuzuari ishte i panjohur.

Më pas, kjo gjykatë më 7 gusht të këtij viti, kishte kërkuar nga Policia e Kosovës, që të verifikonte në regjistrin e gjendjes civile statusin jetësor për të akuzuarin I.I.. Pasi kishte marrë konfirmim zyrtar, gjykatësi Alban Ajvazi, më 16 gusht 2019, kishte marrë vendim për hedhjen e kësaj aktakuze dhe pushimin e kësaj procedure penale.

Sipas aktakuzës, më 29 janar 2016, në rrugën “Ramiz Sadiku”, në Prishtinë, i akuzuari I.I. është hasur duke e shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar. Prokuroria pretendonte se me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, i akuzuari I.I ka bërë anashkalimin e njësisë matëse-njehsorit elektrik, duke futur shiritin filmik nga ana e djathtë për ta penguar punën e diskut, me qëllim që rryma e shpenzuar të mos regjistrohet dhe faturohet fare, me ç’rast të dëmtuarës KEDS, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 206,86 euro.

Ndryshe, kësaj aktakuze i ka paraprirë kallëzimi penal i ushtruar nga ana e KEDS – it më 13 qershor 2016.

¹⁸ “Vazhdon ngritja e aktakuzave ndaj personave që kanë vdekur shumë vite më parë, një e tillë sërish hudhet poshtë”. Betimi për Drejtësi. 27 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/vazhdon-ngritja-e-aktakuzave-ndaj-personave-qe-kane-vdekur-shume-vite-me-pare-nje-e-tille-serish-hudhet-poshte/>).

3.6. Rasti 6 – Aktakuza e ngritur 9 vjet pas vdekjes së të pandehurit¹⁹

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.2884/17

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 20 qershor 2017

Data e vdekjes së të pandehurit: 14 tetor 2008

Prokuroria Themelore në Prishtinë më 20 qershor të vitit 2017, kishte ngritur aktakuzë ndaj Sh.I, me pretendimin se ai kishte kryer veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”. Kjo prokurori e akuzonte atë se pa leje dhe autorizim të furnizuesit të autorizuar ishte furnizuar me energji elektrike, përmes kabllorit elektrik të vendosur jashtë njehsorit elektrik.

Lidhur me këtë aktakuzë, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 24 qershor 2019, kur gruaja e tani të ndjerit, kishte njoftuar gjykatën se i akuzuari Sh.I. kishte vdekur. Më pas, gjykatësja Fatime Dërmaku kishte lëshuar urdhëresë në drejtim të Komunës së Prishtinës për verifikimin e statusit jetësor të të akuzuarit Sh.I.

Komuna e Prishtinës, duke vepruar sipas kësaj urdhërese, gjykatës ia kishte dërguar certifikatën e vdekjes për të akuzuarin Sh.I, me të cilën dëshmohej se ai kishte ndërruar jetë më 14 tetor 2008 dhe si rrjedhojë e kësaj, gjykatësja Dërmaku, më 21 gusht, ka hudhur aktakuzën dhe ka pushuar procedurën penale ndaj Sh.I.

Sipas prokurorisë, më 8 dhjetor 2016, me rastin e kontrollit të bërë nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, në shtëpinë e të akuzuarit Sh.I. është konstatuar se i njëjti pa leje apo autorizim të furnizuesit të autorizuar, e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm është furnizuar me energji elektrike, jashtë njehsorit elektrik përmes kabllorit të vendosur në kulmin e shtëpisë dhe me këtë ka anashkaluar njehsorin dhe është furnizuar pa matje, me ç'rast të dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm material në lartësi prej 162.62 euro.

Aktakuzës së prokurorisë i ka paraprirë një kallëzim penal ndaj të ndjerit, i dorëzuar më 17 janar 2017, nga kompania KEDS.

¹⁹ “Prokuroria ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur më 2008, pushohet procedura ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-me-2008-pushohet-procedura-ndaj-tij/>).

3.7. Rasti 7 – Aktakuza e ngritur 8 vjet pas vdekjes së të pandehurit²⁰

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtrri

Nr. i lëndës: P.nr.675/18

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 21 nëntor 2018

Data e vdekjes së të pandehurit: 3 dhjetor 2010

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, më 21 nëntor të vitit 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj J.D, duke pretenduar se gjatë vitit 2017, ai ka kryer veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”.

Por, sipas dokumenteve zyrtare të gjendjes civile, është konstatuar se ai ka vdekur më 3 dhjetor të vitit 2010, rreth tetë vjet para se të ngritej aktakuza ndaj tij.

Duke u bazuar në këto dokumente, gjykatësi i rastit, Agron Maxhuni ka pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit për vjedhje të rrymës, J.D.

I ndjeri J.D, akuzohej se në periudhën e pacaktuar e deri më 29 maj 2017, në Vushtrri, me qëllim që vetes t’i sjellë dobi të kundërligjshme pasurore ka vjedhur rrymën. Sipas aktakuzës, i pandehuri J.D, në shtëpinë e tij, në Vushtrri, kishte kryqëzuar hyrjen dhe daljen në njehsorin elektrik dhe kishte furnizuar tërë shtëpinë jashtë njehsorit, me ç’rast i kishte shkaktuar dëm kompanisë KEDS, në shumën prej 276.13 euro.

Ndryshe, para ngritjes së aktakuzës, Kompania për Distribimin e Energjisë Elektrike (KEDS), më 5 mars 2018, kishte paraqitur kallëzimin penal në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë ndaj J.D.

²⁰ “Prokuroria në Mitrovicë ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur në vitin 2010, pushohet procedura ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 12 prill 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ne-mitrovice-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-ne-vitin-2010-pushohet-procedura-ndaj-tij/>).

3.8. Rasti 8 – Aktakuza e ngritur 7 vjet pas vdekjes së të pandehurit²¹

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë

Nr. i lëndës: P.nr. 266/2017

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 6 tetor 2017

Data e vdekjes së të pandehurit: 26 nëntor 2010

Prokuroria Themelore në Gjilan, kishte ngritur aktakuzë, ndaj B.T. më 6 tetor 2017. Ai akuzohej se nga koha e pavërtetuar e deri më 12 korrik 2017, në shtëpinë e tij, në fshatin Bolec të Kamenicës, në mënyrë të vazhdueshme dhe të paautorizuar ka shfrytëzuar rrjetin elektrik.

Ndërkaq, në seancën fillestare të këtij rasti, e cila kishte dështuar të mbahej, në gjykatore kishte ardhur djali i tij, i cili kishte njoftuar gjykatën se babai i tij i akuzuar, ka më shumë se tetë vjet që kishte ndërruar jetë. Ai kishte sjellë edhe certifikatën e vdekjes së babait të tij, të lëshuar nga zyra e ofiçarisë në Novobërdë, ku vërtetohet se ai kishte vdekur më 26 nëntor 2010.

Duke marrë parasysh këto rrethana, gjykatësja e rastit, Valbonë Dërvodeli, e ka pushuar procedurën ndaj të akuzuarit B.T.

I ndjeri akuzohej se prej kohës së pavërtetuar e deri më 12 korrik 2017, në kohë të papërcaktuar në shtëpinë e tij, në mënyrë të vazhdueshme dhe të paautorizuar ka përfituar nga shërbimi komunal – rrjeti i shpërndarjes së rrymës së KEDS-it. Në aktakuzë thuhet se i akuzuari është lidhur drejtpërdrejtë në rrjet elektrik jashtë njehsorit, ka shpenzuar energji elektrike pa u regjistruar ajo askund si shpenzim, me ç'rast kompaninë KEDS, e ka dëmtuar në shumë prej 239,31 eurosh.

Kësaj aktakuze i paraprin një kallëzim penal ndaj të ndjerit, i dorëzuar më 11 shtator 2017, nga kompania KEDS – Distrikti në Gjilan.

²¹ “Prokuroria në Gjilan ngritë aktakuzë ndaj personit që ka vdekur më 2010, gjykata pushon procedurën ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 19 mars 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ne-gjilan-ngrite-aktakuze-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-me-2010-gjykata-pushon-proceduren-ndaj-tij/>).

3.9. Rasti 9 – Aktakuza e ngritur 6 vjet pas vdekjes së të pandehurit²²

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: P.nr.4118/16

Vepra penale: Vjedhja e shërbimeve komunale

Data e ngritjes së aktakuzës: 5 tetor 2016

Data e vdekjes së të pandehurit: 5 mars 2010

Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 5 tetor të vitit 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj A.SH, me pretendimin se kishte kryer veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”.

Lidhur me këtë akuzë, në seancën e shqyrtimit fillestar u bë e ditur se i akuzuari ka ndërruar jetë në vitin 2010. Në seancë, prezent ishte djali i të akuzuarit, i cili e njoftoi gjykatën se i akuzuari ka ndërruar jetë para 9 vitesh, me ç’rast gjykatës ia dorëzoi edhe certifikatën origjinale të vdekjes së tani të akuzuarit, me të cilët vërtetohej se ai kishte ndërruar jetë më 5 mars të vitit 2010.

Në këto rrethana, gjykatësi Adnan Isufi deklaroi se gjykata do të merr vendim të veçantë për pushimin e procedurës penale ndaj të akuzuarit A.SH, pas konstatimit se i njëjti ka ndërruar jetë.

Sipas prokurorisë, i akuzuari, që nga datat e pavërtetuar e deri më 27 janar 2014, në shtëpinë e tij në Prishtinë, me qëllim të fshehjes se keqpërdorimeve dhe shmangies së pagesës së energjisë elektrike të cilën e kishte shpenzuar pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, ka manipuluar pllombat shtetërore si dhe numëruesin e njehsorit, ku ishin vërejtur-gjetur gjurmë të gërvishtjes së numrave në numëror, me ç’rast palës së dëmtuar KEDS i ka shkaktuar dëm në lartësi prej 162.93 euro.

Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë i ka paraprirë kallëzimi penal i KEDS – it i datës 9 qershor 2014.

²² “Prokuroria ngritë aktakuzë për vjedhje të shërbimeve komunale ndaj personit që ka vdekur në vitin 2010”. Betimi për Drejtësi. 15 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrite-aktakuze-per-vjedhje-te-sherbimeve-komunale-ndaj-personit-qe-ka-vdekur-ne-vitin-2010/>).

4. Pasojat e shkaktuara nga ngritja e aktakuzave të drejtpërdrejta

Duke marrë për bazë gjetjet konkrete nga procesi sistematik i monitorimit të realizuar nga IKD, qartë vërehet se prokurorët e shtetit nuk po zbatojnë parimet dhe standardet e garantuara me KPPRK, lidhur me barazinë e palëve dhe respektimin e të drejtave procedurale të personave të pandehur në procedurë penale. Në këtë mënyrë po cenohen rëndë të drejtat dhe liritë e njeriut për një proces të paanshëm, të drejtë dhe të pavarur.

Përveç kësaj dhe shkeljeve konkrete të evidentuara në pjesën e parë të këtij raporti, si rrjedhojë e këtyre veprimeve, në këto raste kemi pasoja edhe për buxhetin e shtetit, kjo sepse automatikisht shpenzimet e procedurës bien barrë e gjykatës respektive, bazuar në nenin 454 të KPPRK, ku thuhet se kur pushohet procedura penale [...], gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale [...], shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhet nga mjetet buxhetore [...].²³

Krahas këtyre shpenzimeve, barrë e buxhetit të shtetit bien edhe shpenzimet të cilat realizohen si rrjedhojë e përfaqësimit të lëndës në degën e gjykatës respektive nga ana e prokurorit përkatës, në rastet kur lënda gjykohet në degën gjegjëse të një gjykate.

Mbi të gjitha, ngritja e aktakuzave në një formë të tillë, ka për pasojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, krijimin e pasigurisë juridike, si dhe dëmtimin e imazhit dhe kredibilitetit të sistemit të drejtësisë dhe uljes së besimit të publikut lidhur me integritetin dhe pavarësinë e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

²³ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Neni 454, par. 1.

5. Rekomandimet

1. Prokurorët të sigurohen që të mos cenojnë sigurinë juridike të qytetarëve të Kosovës dhe të zbatojnë në praktikë dispozitat ligjore që garantojnë të drejtat e të pandehurve në procedurë penale;
2. Prokurorët t'i shmangen praktikës së krijuar për ngritjen e aktakuzave të drejtpërdrejta, pa zhvillimin e hetimeve dhe pa marrjen në pyetje të të pandehurve, duke u mjaftuar me përmbushjen e kriterit formal, atë të dënueshmërisë së veprës penale deri në tre vjet burgim;
3. Gjykata t'ia kthejë në plotësim prokurorisë aktakuzat e tilla dhe në rast të mosplotësimit të të njëjtave, t'i hudhë ato si të parregullta.